



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.319/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevi kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore: Antigona Murati, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës(LDK), me seli në Prishtinë, dega në Kamenicë paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, dega në Kamenicë për shkak të shpërndarjes së materialeve zgjedhore në vend votime, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) Anr.319/2019 e datës 06.10.2019, me të cilin ka kërkuar që subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje t'i shqiptohet gjobë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes- shpërndarjes së materialeve zgjedhore në vend votime në ditën e votimit.

A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, dega në Kamenicë me datën 06.10.2019, ka parashtruar ankesë në PZAP, me të cilën pretendohet se me datë 06.10.2019, në afërsi të Qendrës së Vendvotimit, “1009 ne fshatin Rugovë në Kamenicë”, shihet një person duke shpërndar materiale zgjedhore, të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje.

Më këtë rast pretendohet se një gjë e tillë bie ndesh me Ligjin e Zgjedhjeve, rregullat zgjedhore dhe Kodin e Mirësjelljes së partive politike të cilat qartazi parashohin se 24 orë para zgjedhjeve, të gjitha materialet/posteret propagandistike duhet të hiqen ne rast se ndodhen në afërsi prej 100 metrave nga ndonjë Qendër e Vendvotimit.

Në përgjigjën në ankesë, të datës 06.10.2019, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje thekson se, në ankesë nuk është përmendur data e as ora kur ka ndodhur shkelja, nuk dihet vendëndodhja dhe se në foto shihët vetëm një person i pa identifikuar që mban një bluz të veshur me mbishkrimin “Lëvizja Vetëvendosje” dhe se nga foto e ofruar si dëshmi nuk dihet se është në afërsi të ndonjë Qendrës së Votimit.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmerisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe provave materiale-fotografit, të bashkangjitura, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenin 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Nuk është kontestues fakti se përmes fotografisë së dërguar si provë vërehet personi i cili pretendohet se po shpërndan material zgjedhor te subjektit politik të Vetëvendosjes, i cili ka të veshur një bluzë me mbishkrim të Vetëvendosjes.

Paneli, vlerëson se në bazë të fotografisë së prezantuar si provë materiale, e cila gjendet në shkresat e lëndës, nuk mund të konstatohet qartë dhe bindshëm siç përcaktohet me nenin 117 paragrafi 3 të LZP-së, për të provuar se shkelësi i supozuar ka shkelur Kodin e Mirësjelljes, ashtu që në afërsi të Qendrës së Votimit në një distancë më të afërt se 100 metra është bërë shpërndarja e materialit zgjedhor nga aktivist te këtij subjekti.

Në fotografi shihet personi i cili mban një bluzë me mbishkrimin e vetvendosjes ndërsa qendra e votimit nuk shihet, nuk ka mundësi nga një fotografi e tillë të identifikohet qendra e votimit dhe si rrjedhojë në pamundësi të identifikimit të qendrës së votimit, është e pamundur të përcaktohet distanca e kërkuar me ligj.

Po ashtu nga fotoja e ofruar nuk shihet se ka ndonjë Qendër Votuese afër, nga se në foton e ofruar shihet vetëm nje person në një kafiteri .

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.319/2019 më datën 07.10.2017

**Kryesuesi i Panelit
Adnan Koniçević**



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*